



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 12

Tiranë – E mërkurë, 26 janar 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 19.1.2022	Për miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare, në kuadrin e “Projektit të bashkive me energji inteligjente (SEMP)”..... 1257
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.46, datë 26.1.2022	Për miratimin e rregullave të detajuara për procedurën përzgjedhëse të kandidaturave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik..... 1274

**VENDIM****Nr. 38, datë 19.1.2022**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
SË PROJEKTIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË, DHE KONFEDERATËS
ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA
SEKRETARIATI I SHTETIT ZVICERAN
PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE, MBI
DHËNIEN E ASISTENCËS TEKNIKE
DHE FINANCIARE, NË KUADRIN E
“PROJEKTIT TË BASHKIVE ME
ENERGJI INTELIGJENTE (SEMP)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare, në kuadrin e “Projektit të bashkive me energji inteligjente (SEMP)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

MARRËVESHJE PROJEKTI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
DHE KONFEDERATËS ZVICERANE, TË
PËRFAQËSUAR NGA
SEKRETARIATI I SHTETIT ZVICERAN PËR
ÇËSHTJET EKONOMIKE
MBI DHËNIEN E ASISTENCËS TEKNIKE
DHE FINANCIARE, NË KUADRIN E
“PROJEKTIT TË BASHKIVE ME ENERGJI
INTELIGJENTE (SEMP)”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane

mbështetur në Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe nënshkruar në Tiranë, më 11 maj 2007, dhe ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007;

me dëshirën për të forcuar më tej këto marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimin e frytshëm ndërmjet dy vendeve;

me qëllim promovimin e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe social të Republikës së Shqipërisë;

duke vlerësuar angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e reformave, që synojnë ngritjen e një ekonomie tregu, sipas kushteve demokratike dhe ofrimin e një mjedisi të qëndrueshëm nga pikëpamja shëndetësore dhe ekologjike për brezin e sotëm, por edhe për brezat e ardhshëm;

duke pranuar që projekti bazohet në zhvillimin e sektorit privat, hapjen e vendeve të punës, furnizimin me energji të besueshme, lehtësimin e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen e objektivave të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, Strategjinë për Sektorin e Energjisë 2018–2030, dhe në Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Ndryshimet Klimatike 2019–2030;

duke marrë në konsideratë ofrimin e asistencës teknike dhe financiare nga ana e Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike përmes “Projektit për bashki me energji inteligjente (SEMP)”,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:



Neni 1 Përkufizimet

Kudo që janë përdorur në këtë Marrëveshje Projekti, termat në vijim kanë kuptimet e mëposhtme, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe:

a) “MIE” është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë;

b) “SECO” është Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike të Konfederatës Zvicerane;

c) “AEE” është Agjencia për Eficiencën e Energjisë në varësinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

d) “Palët Kontraktuese” janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariati i Shtetit për Çështje Ekonomike të Konfederatës Zvicerane;

e) “Marrëveshja Kuadër” është Marrëveshja e lidhur ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe të nënshkruar më 11 maj 2017 dhe ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007;

f) “Projekt” është Projekti për Bashki me Energji Inteligjente (SEMP);

g) “Marrëveshja e Projektit” është marrëveshja, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese lidhur me Projektin, në vijim referuar edhe si “MP”;

h) “Bashki pilot” janë bashkitë që janë përzgjedhur gjatë studimit të fizibilitetit të Projektit përmes një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje;

i) “MM” është Memorandum Mirëkuptimi, që përcakton më tej të drejtat dhe detyrimet e veçanta për secilën bashki pilot;

j) “NJMP” është Njësia e Menaxhimit të Projektit, që emërohet nga MIE dhe në kohën e nënshkrimit të MP-së është parashikuar që të jetë AEE;

k) “AZP” është Agjencia e Zbatimit të Projektit, që ndodhet në çdo bashki pilot;

l) “Konsulent” është ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë me ekspertizë të specializuar në menaxhim energjie, i cili ka mandatin të mbështesë zbatimin e Projektit;

m) “Furnitor/ë” është kontraktori/kontraktorët

që do të kryejnë punimet dhe sigurojnë furnizimet për realizimin e investimeve me përfitime të shpejta;

n) “Kontributi” është kontributi i parimbursueshëm financiar, që SECO-ja ofron në kuadër të MP-së;

o) “Politika e auditimit financiar e SECO-s” janë udhëzimet për auditimin e projekteve të financuara nga SECO-ja;

p) “Investimet me përfitime të shpejta” janë projektet infrastrukturore që do të realizohen në kuadër të Projektit dhe që do të përqendrohen në vizibilitetin e madh dhe në ndërgjegjësimin e vendimmarrësve dhe të qytetarëve në Bashkitë Pilot; dhe

q) “TVSH” është tatimi mbi vlerën e shtuar.


Neni 2 Objektivi dhe objekti i Projektit

2.1 Objektivi i këtij Projekti është të japë kontribut për zhvillimin e ekonomisë me normë të ulët karboni, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe uljen e ndotjes së mjedisit. Për arritjen e këtij objekti, Projekti do të mbështesë Shqipërinë për përmirësimin e kuadrit të vet për menaxhimin e energjisë, duke pilotuar dhe zgjeruar më tej një sistem bashkiak për menaxhimin e energjisë, që bazohet në instrumentet dhe Metodologjinë e Çmimit Evropian për Energjinë. Së dyti, Projekti do të rrisë kapacitetet e institucioneve kyçe në fushat e menaxhimit të energjisë dhe të përgatitjes së projekteve infrastrukturore bashkiake të suksesshme. Projekti do të lehtësojë qasjen në financim për Bashkitë Pilot në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, sipas një përqsajeje të bazuar në performancë. Linjat kryesore të ndërhyrjes përmbledhen në një përshkrim të Projektit në shtojcën 1.

2.2 Përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij Projekti janë administratat e bashkive pilot të përzgjedhura dhe stafi i AEE-së dhe i MIE-s. Edhe katër bashki të tjera që janë vlerësuar gjatë studimit të fizibilitetit, por që nuk janë përzgjedhur, do të përfitojnë nga masat e ngritjes së kapaciteteve. Tërthorazi, rreth 270.000 banorët e katër bashkive pilot të përzgjedhura përfitojnë nga kursimet në koston e energjisë dhe nga ndriçimi i përmirësuar publik, në kuadër të investimeve me përfitime të shpejta.



2.3 Projekti përbëhet nga pesë komponentë, të cilët paraqiten në tabelën e mëposhtme.



2.4 Komponent opsional: Komponenti 1C është opsional dhe do të zbatohet vetëm nëse arritjet në kuadër të komponentit 1A dhe të komponentit 1B janë të kënaqshme, dhe nëse angazhimi i treguar nga bashkitë pilot, NJMP-ja dhe MIE justifikojnë zbatimin e mëtejshëm në bashki shtesë. Kjo do të vlerësohet nga një vlerësim i jashtëm që do të mandatohet nga SECO-ja.

2.5 Konsulenti i Projektit do të hartojë progresraporte të rregullta, me qëllim monitorimin e arritjeve të Projektit lidhur me objektivat dhe treguesit që janë përcaktuar në kuadrin logjik (shtojca 2). Programi i Projektit pasqyrohet në shtojcën 3.

Neni 3

Shuma dhe përdorimi i kontributit

3.1 SECO-ja bie dakord të mundësojë një kontribut të parimbursueshëm me vlerë të përgjithshme prej 5.300.000 CHF (pesë milionë e treqind mijë franga zvicerane) për zbatimin e Projektit. Buxheti i Projektit është bashkëngjitur në shtojcën 4 për referencë.

3.2 Kontributi është subjekt miratimi lidhur me disbursimet vjetore të SECO-s nga Parlamenti Federal Zviceran.

3.3 Bashkitë pilot Berat, Korçë, Përmet dhe Shkodër kontribuojnë rreth 630.000 CHF (gjashtëqind e tridhjetë mijë franga zvicerane).

3.4 Kontributi individual i secilës bashki përbëhet pjesërisht nga kontribut në mjete monetare dhe kontribut në natyrë. MM-të ndërmjet SECO-s dhe secilës bashki pilot përcaktojnë detajet e kontributeve të tyre individuale.

3.5 Kontributi i bashkive pilot do të përdoret në kuadrin e investimeve me përfitime të shpejta në juridiksionet e tyre përkatëse bashkiake.

3.6 Provigjionet e Projektit, sipas përcaktimeve të shtojcës 4, mund të përdoren në rast shpenzimesh të paparashikuara që hasen gjatë zbatimit të Projektit dhe për veprimtari që lidhen me Projektin, dhe që SECO-ja i konsideron të nevojshme për përfundimin me sukses të Projektit. Vendimi për përdorimin dhe përdorimi i provigjioneve janë në diskrecionin e plotë të SECO-s.

3.7 Shumat e kontributit nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, përveç veprimtarive të planifikuara në kuadër të Projektit.

3.8 Shumat e kontributit nuk përdoren për të paguar taksa apo tarifa, si TVSH, detyrime doganore apo importi të parashikuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë apo çdo ent tjetër në varësi shtetërore.

3.9 Çdo pjesë e pasqyruar e kontributit, që mbetet pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve, përkatësisht pas përfundimit të MP-së, sipas nenit 12, anulohet, përveçse kur bihet dakord ndryshe me shkrim midis Palëve Kontraktuese.

Neni 4

Kushtet e kontributit

4.1 Angazhimi i MIE-s, AEE-së dhe bashkive pilot është faktor kyç për suksesin e Projektit.

4.2 Projekti zbaton me bashkitë pilot një përjasje të bazuar në performancë:

- Kontributi i SECO-s për realizimin e investimeve me përfitime të shpejta në secilën



bashki pilot ndahet në kontribut bazë dhe në kontribut të bazuar në performancë. Kontributi i bazuar në performancë lidhet me arritjen e synimeve të performancës, për të cilat është rënë dakord bashkërisht dhe që janë përcaktuar në MM-të përkatëse për çdo bashki pilot.

- Në përputhje me arritjet në kuadër të komponentit 1A, bashkitë pilot që kanë përmirësuar menaxhimin e energjisë në masë të konsiderueshme, do të përfitojnë mbështetje shtesë nga një grup ekspertësh vendës dhe ndërkombëtarë për hartimin e projekteve të veta infrastrukturore. Kjo mbështetje shtesë prej rreth 100.000 CHF për bashki pilot është e caktuar për përgatitjen e masave të identifikuar në planet përkatëse bashkiake për energjinë.

4.3 Përveçse kur MP-ja përmban dispozita që nuk mbulohen nga termat e Marrëveshjes Kuadër, dispozitat e Marrëveshjes Kuadër gjejnë zbatim të plotë. Në veçanti, Qeveria e Shqipërisë siguron kushtet për zbatimin e Projektit, sipas nenit 4 të Marrëveshjes Kuadër.

4.4 MIE lehtëson importin e përkohshëm në dhe rieksporimin vijues nga Shqipëria të të gjitha pajisjeve në pronësi të Konsulentit, furnitorit dhe cilitdo eksperti tjetër të huaj, që lidhet me ofrimin e shërbimeve të tyre.

4.5 Për të siguruar vizibilitetin e kontributit, të gjitha materialet e prodhuara, në kuadër të marrëdhënieve me publikun, dhe të gjitha dokumentet e hartuara, në kuadër të Projektit, i referohen faktit se Projekti financohet nga Konfederata Zvicerane dhe përmbajnë logon e Konfederatës Zvicerane.

4.6 MIE vë në dispozicion buxhetin e nevojshëm për garantimin e rimbursimit të TVSH-së lidhur me shpenzimet përkatëse të Projektit në një shumë të përllogaritur prej 650.000 CHF (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë franga zvicerane) gjatë periudhës së zbatimit të Projektit, që pritet të jetë nga data 1.4.2021 deri 31.12.2026.

Neni 5

Organizimi i Projektit dhe përgjegjësitë e Palëve Kontraktuese

5.1 Partneriteti

5.1.1 Projekti është një sipërmarrje e përbashkët e MIE-s, AEE-së, bashkive pilot dhe SECO-s.

5.1.2 MIE emëron NJMP-në me qëllimin e

sigurimit të homologut më të përshtatshëm kombëtar për këtë Projekt. Në momentin e nënshkrimit të MP-së, MIE emëroi AEE-në në cilësinë e NJMP-së. Ndryshimet në emërimin e NJMP-së i nënshtrohen miratimit nga ana e SECO-s.

5.2 Përgjegjësitë e MIE-s dhe NJMP-së

5.2.1 MIE është përgjegjëse për zbatimin strategjik të Projektit. Ajo ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e suksesshëm të Projektit. Ajo bashkërendon me autoritetet qeveritare të përfshira në veprimtaritë e Projektit në nivel kombëtar dhe nënkombëtar. Ajo ofron qasje në informacionet përkatëse, përfshirë të dhëna statistikore, të cilat konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Për përdorimin e tij për qëllime të tjera, merret pëlqimi paraprak me shkrim i MIE-s.

5.2.2 MIE ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar qasjen e plotë dhe të shpejtë të personave të përfshirë në Projekt në informacionin e nevojshëm teknik dhe institucional në nivel kombëtar dhe bashkiak.

5.2.3 MIE ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i dhënë sa më shpejt dhe pa pengesa të panevojshme administrative stafit ndërkombëtar të Konsulentit dhe furnitorit, si dhe të gjithë ekspertëve të tjerë të angazhuar në Projekt, vizat e nevojshme të hyrjes pa pagesë, si dhe përjashtim nga detyrimet doganore, tatimore dhe detyrime të tjera të përcaktuara në ligjet e Republikës së Shqipërisë apo të entiteteve në varësi të Shtetit dhe që këto të zbatohen për të gjitha pagat, sendet personale dhe pajisjet e nevojshme për detyrat e tyre, në kuadër të Projektit.

5.2.4 MIE siguron akses në dy fonde kundërpartit të krijuara nga Projekti i Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Lumit Drin me vlerë të përgjithshme prej 25.750.000 CHF. Në përputhje me dispozitat për përdorimin e këtyre fondeve, MIE ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar që investimet bashkiake të identifikuar nga AZP-të, në planet përkatëse të energjisë bashkiake, të mund të financohen nga këto fonde homologe. Në shtojcën 5 jepet më shumë informacion mbi përdorimin dhe administrimin e fondeve homologe.



5.2.5 NJMP-ja është pika e kontaktit në nivel kombëtar për Konsulentin dhe SECO-n dhe ajo menaxhon dhe koordinon të gjitha veprimtaritë administrative të Projektit. NJMP-ja mbështet në veçanti zbatimin e komponentit 1B dhe të komponentit 1C, si edhe pjesë të komponentit 1A dhe të komponentit 2B, të cilat kanë të bëjnë me nivelin kombëtar.

5.2.6 NJMP-ja ndërmerr ose siguron ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zbatimin e suksesshëm të Projektit në tërësi. NJMP-ja shqyrton progresraportet e Konsulentit dhe harton një dokument reagimi/vlerësimi me shkrim, që i dorëzohet SECO-s.

5.2.7 Në përputhje me nenin 4.6, MIE është përgjegjëse për rimbursimin e shpejtë të TVSH-së së Konsulentit dhe të furnitorëve pa pengesa të panevojshme administrative.

5.2.8 NJMP-ja i siguron Konsulentit ambient zyre, mundësisht në të njëjtën godinë me NJMP-në, dhe mbulon kostot e zakonshme të funksionimit të zyrës. Në rast se NJMP-ja nuk ka mundësi të sigurojë hapësirë të përshtatshme për zyrë, MIE ndërmerr këtë detyrim. NJMP-ja dhe MIE i siguron Konsulentit akses për përdorimin e sallave të mbledhjeve në këtë godinë.

5.3 Përgjegjësitë e bashkive pilot

5.3.1 Partnerët e drejtpërdrejtë të Projektit në nivel bashkiak janë AZP-të, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Projektit në nivel bashkiak, veçanërisht komponentit 1A dhe komponentit 2A, si dhe veprimtaritë e komponentit 2B, që kanë të bëjnë me nivelin bashkiak.

5.3.2 Bashkitë ndërmarrin ose sigurojnë ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zbatimin e suksesshëm të Projektit në tërësi. Roli dhe përgjegjësitë e bashkive pilot janë të përcaktuara në më shumë detaje në MM-të e veçanta që nënshkruhen ndërmjet SECO-s dhe bashkisë përkatëse. MM-të rregullohen nga kjo MP. Në rast ndryshimi apo mospërputhje, mbizotëron MP-ja.

5.3.3 Bashkitë sigurohen që nëpunësit civilë përgjegjës për menaxhimin e energjisë në administratën bashkiake, janë të disponueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Projektit dhe për të kryer detyrat që rrjedhin nga Projekti gjatë kohëzgjatjes së tij.

5.4 Përgjegjësitë e Konsulentit

5.4.1 Konsulenti mandatohet të zbatojë këtë Projekt. Konsulenti ndërmerr të gjitha detyrat administrative dhe mbikëqyrëse të Projektit, përfshirë monitorimin dhe raportimin.

5.4.2 Konsulenti do të punojë ngushtë me NJMP-në, AZP-të, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

5.4.3 Konsulenti do të hartojë progresraporte periodike dhe informon rregullisht Komitetin Drejtues, NJMP-në dhe SECO-n lidhur me të gjitha zhvillimet përkatëse.

5.5 Përgjegjësitë e SECO-s

5.5.1 SECO-ja është autoriteti përgjegjës për zbatimin strategjik të Projektit dhe:

- jep një kontribut të parimbursueshëm, siç përshkruhet më lart në nenin 3.1.

- monitoron arritjen e synimeve dhe rezultateve të Projektit;

- paguan Konsulentin e Projektit në afate të përshtatshme pas miratimit me shkrim nga palët përgjegjëse, siç përshkruhet në nenin 6 më poshtë:

5.5.2 Ambasada e Zvicrës në Tiranë përfaqëson SECO-n në Komitetin Drejtues, në mungesë të menaxherit të Programit të SECO-s, që është përgjegjës për Projektin.

5.6 Komiteti Drejtues

5.6.1 Komiteti Drejtues, i përbërë nga përfaqësues të MIE, përfaqësues të NJMP-së, kryetarët apo nënkryetarët e bashkive pilot, përfaqësuesit e SECO-s dhe/ose Ambasadës së Zvicrës në Tiranë, siguron drejtimin dhe mbështetjen strategjike për zbatimin e suksesshëm të veprimtarive të Projektit dhe arritjen e rezultateve të pritshme, si dhe krijon transparencë dhe mëkon pronësi të Projektit ndër palët kryesore të interesit.

5.6.2 Komiteti Drejtues mbledhet të paktën një herë në vit dhe bashkëdrejtohet nga NJMP-ja dhe SECO-ja.

5.6.3 Sekretariati i Komitetit Drejtues sigurohet nga NJMP-ja.

Neni 6

Prokurimi dhe kontratat

6.1 Konsulenti

6.1.1 Në përputhje me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë, prokurimi i shërbimeve të Konsulentit është realizuar tashmë si një paketë gjatë tenderimit të shërbimeve për Studimin e



Fizibilitetit, që është kryer në vitin 2019. Kjo procedurë prokurimi përfshinte alternativat që mbulojnë të gjitha shërbimet për zbatimin e Projektit në tërësi. Kjo është bërë me objektivin për të siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nga i njëjti Konsulent gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit. Konsulenti me të cilin SECO ka lidhur marrëveshjen është një konsorcium i përbërë nga shoqëri gjermane, zvicerane dhe shqiptare.

6.1.2 Kontrata për zbatimin e shërbimeve do të lidhet midis Konsulentit dhe MIE-s duke përdorur një format kontrate të SECO-s. Kontrata dhe ndryshimet e mundshme të saj i nënshtrohen miratimit të SECO-s.

6.2 Fondi i përgatitjes së Projektit

6.2.1 Shërbimet në kuadër të Fondit të Përgatitjes së Projektit do të prokurohen sipas legjislacionit zviceran për prokurimet. Përbërja e grupit të ekspertëve në këtë fond do të vendoset me marrëveshje ndërmjet NJMP-së, Konsulentit dhe SECO-s. SECO-ja ka të drejta të pakundërshtueshme sa i përket përcaktimit të ofruesit për shërbimet, në kuadër të Fondit të Përgatitjes së Projektit.

6.2.2 Fondi i Përgatitjes së Projektit administrohet nga Konsulenti dhe si pasojë është i integruar në Kontratën për Zbatimin e Shërbimeve ndërmjet MIE-s dhe Konsulentit.

6.3 Investimet me përfitime të shpejta

6.3.1 Procesi i prokurimit të furnitorit/furnitorëve për zbatimin e investimeve me përfitime të shpejta bazohet në ligjin shqiptar për prokurimet, duke qenë se ideja themelore e këtij komponenti është t'i aftësojë më tej bashkitë në sistemin e tyre duke përdorur dokumentacionin standard.

6.3.2 Procesi i prokurimit për investimet me përfitime të shpejta do të kryhet nga AZP-të me mbështetjen e NJMP-së dhe të Konsulentit. Një manual operacional i përgatitur nga Konsulenti në këshillim me N-në dhe AZP-të, do të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë e AZP-ve, NJMP-së dhe Konsulentit për të gjithë procesin e përgatitjes, realizimit dhe vënies në funksion të investimeve me përfitime të shpejta. Manuali operacional i nënshtrohet miratimit nga SECO-ja.

6.3.3 Kontrata/kontratat për zbatimin e investimeve me përfitime të shpejta lidhen ndërmjet bashkive pilot dhe furnitorit/furnitorëve.

6.3.4 Sipas miratimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe MP-së së nënshkruar dhe MM-së, bashkia përkatëse pilot hap një llogari të veçantë në një bankë të nivelit të dytë për kontributin me grant të SECO-s për financimin e investimeve me përfitime të shpejta. Nëse pranohet nga banka, llogaria do të jetë një llogari e besuar një të treti (*escrow*), që kërkon miratimin e SECO-s për ekzekutimin e pagesave. Kjo llogari përdoret për të paguar furnitorët e investimeve me përfitime të shpejta të financuara nga SECO-ja.

6.3.5 Në rast se një llogari garancie (*escrow*) një të treti nuk është e realizueshme, ndërmjet bankës së nivelit të dytë dhe bashkisë përkatëse pilot nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje bashkëpunimi përcakton se banka e nivelit të dytë mund të transferojë pagesat në drejtim të furnitorit/furnitorëve, vetëm pas marrjes së dokumentacionit në vijim: i. faturën përkatëse të konfirmuar nga bashkia pilot; dhe ii. miratimin me shkrim nga SECO-ja. Në të kundërt, banka nuk përpunon transfertën.

6.3.6 Kontratat për zbatimin e investimeve me përfitime të shpejta do të lidhen ndërmjet bashkisë pilot dhe furnitorit/furnitorëve, pasi kontributi me grant i SECO-s për financimin e investimeve me përfitime të shpejta të jetë transferuar në llogarinë e veçantë për investimet me përfitime të shpejta.

6.3.7 Pagesat për Konsulentin, të cilat lidhen me investimet me përfitime të shpejta kryhen drejtpërsëdrejti nga SECO-ja, që miraton faturat dhe kryen pagesat.

6.3.8 Referuar nenit 3.9, çdo pjesë e papërdorur e Kontributit me grant të SECO-s për investimet me përfitime të shpejta, që mbetet pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve, transferohet në thesarin e shtetit zviceran, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim ndërmjet MIE-s dhe SECO-s.

6.4 Menaxhimi i fondeve homologe

6.4.1 MIE i cakton NJMP-së mandat për menaxhimin e dy fondeve kundërparti të krijuara nga Projekti i Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Lumit Drin, me vlerë të përgjithshme prej 25.750.000 CHF (shihni shtojcën 5 për detaje).

6.5 Klauzolat e prokurimit të përgjithshëm

6.5.1 Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e siguruar me fondet e SECO-s për përdorim në kuadër të Projektit, i vihen Projektit në dispozicion, në mënyrë të pakufizuar dhe nuk devijohen nga



Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SECO-s.

6.5.2 Nëse, për çfarëdo lloj arsyeje Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të siguruara përmes kontributit zviceran menaxhohet nga SECO-ja me diskrecion të plotë. Në fund të Projektit, SECO vendos për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar, në kuadër të Projektit.

6.6 Auditimi financiar dhe vlerësimi i Projektit

6.6.1 Audituesit që kryejnë auditet e Projektit (p.sh., për të gjithë Projektin apo për komponentë të veçantë) kontraktohen nga SECO-ja. Kontrata nënshkruhet ndërmjet SECO-s dhe audituesve të përzgjedhur. SECO-ja miraton faturat dhe bën pagesat drejtpërsëdrejti.

6.6.2 SECO-ja rezervon të drejtën të emërojë ekspertë për të kryer studime vlerësimi gjatë zbatimit të Projektit ose pas përfundimit të Projektit. Kontrata për një studim opsional të vlerësimit prokurohet nga SECO-ja, në përputhje me udhëzimet zvicerane të prokurimit. Kontrata nënshkruhet midis SECO-s dhe ekspertit/ekspertëve të përzgjedhur. SECO-ja miraton faturat dhe bën pagesat drejtpërsëdrejti.

Neni 7

Zbatimi i Projektit

7.1 Si parim që drejton zbatimin e projektit, anëtarët e të gjithë organeve të përfshira bëjnë gjithmonë çdo përpjekje të mundshme për të vepruar në frymën e bashkëpunimit dhe për të marrë vendime me konsensus. Kur lind nevoja, Palët Kontraktore, me kërkesë të njëres prej Palëve:

a) shkëmbejnë pikëpamjet e tyre lidhur me përmbushjen e detyrimeve përkatëse, në kuadër të MP-së, administrimin e kontributit dhe operacioneve të financuara nga kontributi;

b) i ofrojnë Palës tjetër Kontraktore të gjitha informacionet që ajo i kërkon, në mënyrë të arsyeshme, lidhur me ekzekutimin e kontributit dhe operacionet e financuara nga kontributi.

7.2 Palët Kontraktore e informojnë në kohë njëra-tjetrën për çdo situatë që ndërhyt ose mund të ndërhyt në arritjen e qëllimit të kontributit ose përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse në kuadër të MP-së.

7.3 Palët Kontraktore mbajnë dokumentacionin dhe dosjet e tyre përkatëse lidhur me ekzekutimin e

Projektit dhe përdorimin e kontributit. Ato i ruajnë të gjitha dokumentet lidhur me MP-në dhe zbatimin e saj për të paktën dhjetë vjet pas përfundimit të Projektit.

7.4 Në çdo moment të Projektit mund të kryhet një kontroll financiar, sipas Politikës së SECO-s për Kontrollin Financiar (shih nenin 6.6 më lart).

7.5 Në çdo moment, SECO mund të organizojë misione vlerësimi, me qëllim sigurimin e zbatimit të efektshëm dhe efikas të Projektit dhe përdorimit të kontributit, si dhe të arritjes së objektivave përkatëse. Në këshillim me NJMP-në dhe AZP-të, dhe pas zbatimit të projektit, por, në çdo rast, jo më vonë se katër muaj nga përfundimi i MP-së, Konsulenti i dorëzon SECO-s një raport lidhur me këtë objekt dhe sipas detajeve të arsyeshme të kërkuara nga ky i fundit, për ekzekutimin e Projektit dhe arritjen e qëllimit të kontributit.

Neni 8

Klauzola kundër korrupsionit

Palët Kontraktore ndajnë interesin e përbashkët të luftës kundër korrupsionit, i cili vë në rrezik qeverisjen e mirë dhe përdorimin e përshtatshëm të burimeve të nevojshme për zhvillim, si dhe rrezikon konkurrencën e hapur dhe të ndershme me bazë çmimin dhe cilësinë. Prandaj, ato deklarojnë qëllimin për të bashkuar përpjekjet e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe, në veçanti, deklarojnë se çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim apo përfitim i çfarëdo lloji natyre nga kushdo, qoftë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, me qëllim marrjen e një mandati apo lidhjen e një kontrate, në kuadër të MP-së ose gjatë zbatimit të saj, interpretohet si akt i paligjshëm dhe praktikë korruptive. Çdo akt i kësaj natyre është më se i mjaftueshëm për të justifikuar ndërprerjen e MP-së, prokurimit ose akordimit, që vjen si pasojë e saj ose për të marrë masa të tjera korrigjuese të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Palët Kontraktore informojnë njëra-tjetrën në kohë lidhur me çdo dyshim me baza për korrupsion.

Neni 9

Bazat e bashkëpunimit

Respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave themelore të njeriut, të përcaktuara veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave



të Njeriut, qëndron në bazë të politikave të brendshme të Palëve Kontraktore dhe përfaqëson një element thelbësor po aq të rëndësishëm sa edhe objektivat e kësaj MP-je.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët Kontraktore përdorin negociatat diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i dispozitave të MP-së.

Neni 11

Ndryshimet ose amendimet, shtojcat

1.1 Çdo ndryshim ose amendim i MP-së dhe i shtojcave të bëra nga Palët Kontraktore të kësaj MP-je bëhen vetëm me shkrim dhe me dakordësinë apo konsensusin e Palëve Kontraktore.

11.2 Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj MP-je:

Shtojca 1: Përshkrimi i Projektit

Shtojca 2: Kuadri logjik

Shtojca 3: Programi i Projektit

Shtojca 4: Buxheti i Projektit

Shtojca 5: Përdorimi dhe administrimi i fondeve homologe

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe zgjidhja

12.1 MP-ja hyn në fuqi me nënshkrimin e Palëve. Ajo mbetet në fuqi derisa të gjitha detyrimet në kuadër të saj të jenë përmbushur, çka pritët të ndodhë deri më 31 dhjetor 2026.

12.2 Secila palë gëzon të drejtën e pezullimit ose të zgjidhjes së MP-së, kurdo qoftë, pasi ta ketë njoftuar me shkrim palën tjetër 6 muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund ta zgjidhë këtë MP me efekt të menjëhershëm, në rast të ndonjë shkeljeje thelbësore të MP-së, pasi të ketë

dërguar njoftim me shkrim. Shkeljet thelbësore janë shkelje të rënda të një prej objektivave themelorë të MP-së ose mospërmbushje madhore e detyrimeve të Palëve Kontraktore.

12.3. Në rast të zgjidhjes së MP-së, sipas pikës 2 të nenit 12, dispozitat e MP-së vijnë në gjejmë zbatim për të gjitha kontratat në fuqi në momentin e zgjidhjes së MP-së, deri në momentin përkatës të zgjidhjes së këtyre kontratave.

Neni 13

Baza ligjore

Marrëveshja Kuadër është pjesë përbërëse e MP-së. Në rast mospërputhjeje në përmbajtje ndërmjet marrëveshjeve, mbizotëron MP-ja. Gjen zbatim legjislacioni zviceran për degët.

Neni 14

Gjuha

I gjithë letërkëmbimi me SECO-n, përfshi të gjitha dokumentet, miratime faturash, raporte apo dokumente të tjera të lidhura me projektin hartohen në anglisht.

Neni 15

Përgjegjësia

SECO-ja nuk mban asnjë përgjegjësi dhe nuk ka asnjë detyrim ndaj dëmeve, dëmtimeve apo efekteve të tjera të mundshme negative të shkaktuara nga Projekti, përfshi, por pa u kufizuar në papërputhshmëritë e mundshme të planifikimit të Projektit apo të Projekteve të tjera, që mund të cenojnë Projektin ose që mund të shkaktojnë shqetësim publik.

Lidhur në Tiranë, më 15.11.2021, hartuar në dy kopje origjinale, secila në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje lidhur me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të MP-së, mbizotëron versioni në anglisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

.....
Belinda Balluku
Ministër

Në emër të Konfederatës Zvicerane

.....
Adrian Maître
Ambasador

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Lexuar dhe rënë dakord nga:

Për Bashkinë Shkodër

Për Bashkinë Berat

Znj. Voltana Ademi

Z. Ervin Demo

Kryetare Bashkie

Kryetar Bashkie

Për Bashkinë Korçë

Për Bashkinë Përmet

Z. Sotiraq Filo

Znj. Alma Hoxha

Kryetar Bashkie

Kryetare Bashkie

SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Shënim. Projektimi i Projektit do të përfundohet gjatë fazës së ideimit në vitin 2021.

Ndikimi: Bashkitë me eficiencë energjie japin kontribut për zhvillimin e ekonomisë me normë të

ulët karboni, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe uljen e ndotjes së mjedisit.

SEMP-ja jep kontribut për arritjen e këtij objektivit përmes zbatimit të pesë komponentëve në kuadër të dy rezultateve, siç paraqitet në tabelën në vijim. Shtojca 3 paraqet një vijë kronologjike të zbatimit të komponentëve.




Tabela 1. Rezultatet dhe komponentët e SEMP-së

Rezultati 1: Një kuadër i përshtatshëm i menaxhimit të energjisë përmirëson menaxhimin e energjisë në nivel bashkiak dhe kombëtar

Gjatë studimit të fizibilitetit, Konsulenti konfirmoi Çmimin Evropian të Energjisë (ÇEE) si formatin më të mirë të mundshëm për krijimin e një kuadri të menaxhimit të energjisë për bashkitë e Shqipërisë. Në kontrast me natyrën vullnetare të ÇEE-së në Evropë, SEMP-ja në Shqipëri synon të krijojë një kuadër që përqendrohet kryesisht në përputhshmërinë me legjislacionin dhe rregulloret

ekzistuese (aspektet e detyrueshme) dhe në masa me vlerë të madhe të shtuar për bashkitë (p.sh., ndikim ekonomik të drejtpërdrejtë).

Komponenti 1A – Bazuar në instrumentet dhe metodologjinë e ÇEE-së në katër bashkitë pilot do të zbatohet një sistem i përshtatur i menaxhimit të energjisë. SEMP-ja do të ndihmojë bashkitë në krijimin e strukturave të përshtatshme administrative, kryerjen e diagnostikimit të energjisë dhe ideimin e një vizioni për energjinë. Duke marrë këtë si bazë, do të hartohet një plan bashkiak për energjinë, që u jep



përparësi masave. Me mbështetjen e Projektit, bashkitë pilot do të zbatojnë këto masa bazuar në metodologjinë e ÇEE-së, ndërsa synimi përfundimtar është certifikimi për menaxhim të shëndoshë të energjisë. Me qëllim lehtësimin e përmirësimit dhe të monitorimit të vazhdueshëm do të sigurohen instrumente menaxhimi cilësor dhe sasior, që do të përshtaten për nevojat vendore (p.sh., programimi i një ndërfaqeje të re për instrumentin e menaxhimit të të dhënave të energjisë). Gjithashtu, shkëmbimet ndërmjet bashkive pilot, si dhe ato me bashki të tjera të ÇEE-së, do të mbështesin zbatimin e sistemit të menaxhimit të energjisë.

Bazuar në metodologjinë e certifikimit të ÇEE-së¹, do të hartohet një udhëzues vlerësimi për menaxhimin e shëndoshë të energjisë, i cili bën të mundur vlerësimet e standardizuara dhe klasifikimin e cilësisë së menaxhimit bashkiak të energjisë. Konsulenti do të vlerësojë performancën e çdo bashkie pilot. Ky vlerësim do të jetë vendimtar për volumin e investimeve me përfitime të shpejta dhe aksesin në financime (shihni komponentin 2A).

Komponenti 1B – SEMP-ja do të hartojë një kuadër kombëtar të menaxhimit të energjisë.

Bazuar në përvojën e krijuar në kuadër të komponentit 1A, Konsulenti do të hartojë së bashku me të gjitha palët përkatëse të interesit në Shqipëri, një kuadër kombëtar të menaxhimit të energjisë. Ky përfshin një sistem të standardizuar të menaxhimit të energjisë në bashki, organizimin institucional, një propozimin për një proces certifikimi, modelin e financimit dhe të punës, si dhe një strategji për shtrirjen e këtij kuadri në të gjitha bashkitë.

Komponenti 1C (opsional) – SEMP-ja do të mbështesë shtrirje e kuadrit të menaxhimit të energjisë. Konsulenti do të përfundojë hartimin e një kuadri kombëtar të menaxhimit të energjisë, do të mbështesë nisjen e funksionimit dhe vendosjen e tij në qeverinë qendrore, do të përcaktojë kërkesat për audituesit e energjisë, do të trajnojë menaxherët vendorë të energjisë, si dhe do të mbështesë

strategjinë e shtrirjes dhe promovimit të kuadrit. Për më tepër, përmes, p.sh., transfertave qeveritare apo një mekanizmi kombëtar financimi, do të krijohen skema afatgjata shtysash të lidhura me performancën e bashkisë në menaxhimin e energjisë (shihni komponentin 2A më poshtë për detaje).

Shënim. Komponenti 1C është opsional dhe do të zbatohet vetëm nëse arrijtjet në kuadër të komponentit 1A/B janë të kënaqshme dhe nëse angazhimi i treguar nga bashkitë pilot, NJMP-ja dhe MIE justifikojnë shtrirjen e mëtejshme në bashki të tjera. Kjo do të vlerësohet përmes një vlerësimi të jashtëm.

Rezultati 2: Qytetarët e bashkive të përzgjedhura përfitojnë nga shërbime publike me eficiencë energjie të ofruara nga administrata të efektshme

Komponenti 2A – SEMP-ja do të forcojë kapacitetet e bashkive për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve infrastrukturore përmes zbatimit të investimeve me përfitime të shpejta. Investimet me përfitime të shpejta veprojnë si “projekte demonstrim” për publikun dhe bashki të tjera dhe si shembuj rastesh të përgatitjes dhe të zbatimit më të mirë të projekteve infrastrukturore në secilën bashki pilot. Për këtë qëllim, gjatë Studimit të Fizibilitetit, Konsulenti analizoi të gjitha fushat e mundshme të investimit që janë nën përgjegjësinë e bashkive. Ai arriti në përfundimin se ndriçimi rrugor ishte alternativa më e favorshme, për shkak të ndikimit të madh në pakësimin e kërkesës dhe të kostos së energjisë, kompleksitetit të ulët, vizibilitetit të dukshëm në qytete, përfitimet e përbashkëta, për shkak të sigurisë së shtuar dhe faktit që qytetet bëhen më tërheqëse, mundësisë për replikim dhe përshkallëzim. Ky komponent përfshin mbështetje për të gjitha veprimtaritë, që nga planifikimi e deri tek mirëmbajtja e projekteve bashkiake për ndriçimin rrugor. Gjithashtu, Konsulenti do të ofrojë trajnim të veçantë për identifikimin e projekteve, studimet e fizibilitetit, projektimet teknike, prokurimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projektit.

SEMP-ja lehtëson aksesin në financim pas një qasjeje të bazuar në performancë. Buxheti për investimet me përfitime të shpejta ndahet në kontribut bazë dhe në kontribut të bazuar në performancë. Kontributi i bazuar në performancë

¹ ÇEE-ja nuk është vetëm një sistem menaxhimi energjie, por edhe një sistem certifikimi për bashkitë. Nëse një auditor i jashtëm konfirmon arrijtjet në menaxhim energjie, në përputhje me sistemin e klasifikimit të ÇEE-së, bashkisë i jepet Çmimi Evropian i Energjisë. Shkalla më e lartë është Çmimi i Artë Evropian i Energjisë.



lidhet me arritjen e synimeve të performancës për të cilat është rënë dakord bashkërisht gjatë përgatitjes së investimeve me përfitime të shpejta.

SEMP-ja do të sigurojë shtysa të tjera për bashkitë që kanë performancë të mirë dhe që certifikohen:

Fondi i Përgatitjes së Projektit: Në përputhje me arritjet në kuadër të komponentit 1A, bashkitë që kanë përmirësuar menaxhimin e energjisë në masë të konsiderueshme do të përfitojnë mbështetje shtesë nga një grup ekspertësh vendës dhe ndërkombëtarë për hartimin e projekteve të veta infrastrukturore. Kjo mbështetje shtesë prej rreth 100.000 CHF për bashki, është e caktuar për përgatitjen e masave të identifikuar në planet e bashkisë për energjinë, në kuadër të komponentit 1A, me ambicien që të hartohen projekte të suksesshme, të cilat mund të mbështeten nga fonde ekzistuese dhe mekanizma financimi të IFN-ve. Grupi i ekspertëve do të administrohet nga Konsulenti.

Akresi në Fonde Investimesh: Bashkitë që në periudhën afatmesme arrijnë të certifikohen do të përfitojnë akses në fondet homologe për realizimin e investimeve infrastrukturore në shkallë të vogël. Konsulenti do të ofrojë mbështetje specifike dhe do të lehtësojë këtë akses. Parashikohet që në periudhën afatgjatë bashkitë që arrijnë të gjitha nivelet e certifikimit të bashkohen me programe financimi të IFN-ve, si edhe me mekanizma financimi kombëtarë, për shembull². Kjo do të sigurojë shtysa shtesë për përmirësimin e performancës së menaxhimit të energjisë dhe përgatitjes së projekteve të suksesshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Komponenti 2B – Forcimi institucional, ndërgjegjësimi dhe masat e dialogut të politikave. Konsulenti do të ofrojë asistencë teknike dhe trajnim kryesisht për institucionet kyçe të administratave bashkiake në sektorin e energjisë, si edhe për Agjencinë e Eficiencës së Energjisë në nivel kombëtar. Kjo mbështetje është plotësuese e komponentit 2A dhe përqendrohet në menaxhimin e energjisë. Për shembull, ajo përfshin auditimin e energjisë, rregulloret dhe menaxhimin e të dhënave të energjisë. Masat e ndërgjegjësit për vendimmarrësit dhe popullsinë do të mbështesin hartimin dhe zbatimin e strategjive bashkiake të komunikimit dhe ndërgjegjësit, si dhe do të tërheqin mbështetje politike për SEMP-in. Në nivel kombëtar, masat e dialogut të politikave do të ndërmerren në bashkëpunim me partnerë të tjerë për zhvillim për të mbështetur politikat e favorshme dhe kuadrin rregullator që krijon hapësirë për menaxhimin e qëndrueshëm të energjisë dhe mëkon pranimin e kuadrit të standardizuar të menaxhimit të energjisë të SEMP-it.

² Krijimi i këtij mekanizmi financiar shqiptar është i mishëruar në ligjin shqiptar për eficiencën e energjisë. Megjithatë afatet e tij janë të paqarta. SEMP-ja parashikon të ofrojë mbështetje për krijimin e këtij mekanizmi financimi në strukturat e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë.



SHTOJCA 2

KUADRI LOGJIK (PARAPRAK)

Shënim. Kuadri logjik do të përfundohet gjatë fazës së ideimit në vitin 2021. Në veçanti, kjo përfshin përcaktimin e bazës fillestare dhe vlerat e synuara.

Projekti për Bashki me Energji Inteligjente		Shqipëri	UR-01059.10.01
Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyç të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorët e jashtëm (supozime)
Ndikimi	Treguesit e ndikimit		
Bashkitë me eficiencë energjie japin kontribut për zhvillimin e ekonomisë me normë të ulët karboni, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe uljen e ndotjes së mjedisit.	- TP 10: Shkarkimet e gazit serrë të kursyera ose të shmangura në CO₂ eq. - TP 11: Kilovat orë të kursyera përmes masave të eficiencës së energjisë ose kilovat orë shtesë të prodhuara me energji të rinovueshme. - Vlera në euro e kursyer në faturat e energjisë elektrike në vit.	- Raporti i përfundimit të Projektit	- Asnjë fatkeqësi e madhe natyrore, pandemi, apo mungesë stabiliteti ekonomik nuk e pengon zbatimin e projektit.
Rezultatet	Treguesit e rezultateve*		
Rezultati 1: Kuadër i përmirësuar i menaxhimit të energjisë Një kuadër i përshtatshëm i menaxhimit të energjisë përmirëson menaxhimin e energjisë në nivel bashkiak dhe kombëtar.	- TP 1: Masa për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe institucional. - TP 7: Numri i qyteteve me masa për zhvillim të qëndrueshëm urban dhe numri i banorëve përfitues.	- Raportimi për projektin	- Autoritetet kombëtare dhe bashkiake vijnë të jenë të gatshme të zbatojnë dokumentet strategjike kombëtare dhe ligjin për EE-në.
Rezultati 2: Shërbime më të mira përmes institucioneve të efektshme Qytetarët e bashkive të përzgjedhura përfitojnë nga shërbime publike me eficiencë energjie të ofruara nga administrata të efektshme.	- TP 4: Masa për përmirësimin e kapaciteteve/ aftësive institucionale dhe profesionale. - TP 8: Numri i personave me akses në shërbime publike infrastrukturore më të mira. - TP 9: Efekti promovues i mbështetjes së SECO-s në investimet publike (për klimën) në USD.	- Raportimi për projektin	- Rritja e çmimeve të energjisë ofron shtysa të shtuara për masat e EE-së dhe kalimin në furnizim të decentralizuar nga burime të energjisë së rinovueshme. - Bashkitë kanë në dispozicion personel të kualifikuar të mjaftueshëm. - Lëvizshmëria e personelit nuk ndikon zhvillimin e qëndrueshëm të dijes institucionale.
Produktet	Treguesit e produkteve		
Produkti 1a: Një sistem i përshtatur i menaxhimit të energjisë, i frymëzuar nga Çmimi Evropian i Energjisë, u mundëson bashkive të përzgjedhura shqiptare të	- Në katër bashkitë pilot institucionalizohen strukturat bashkiake të menaxhimit të energjisë së bashku dhe stafi përkatës përmbush detyrat në mënyrë të qëndrueshme. - Planet Bashkiake të Energjisë (PBE) janë në zbatim.	- Aktet bashkiake - PBE-të - Instrumentet e ÇEE-së - Masat e komunikimit në bashki	- Interesi i drejtuesve dhe i stafit bashkiak mbetet i lartë gjatë gjithë Projektit. Kjo do të mbështetet nga një qasje e bazuar në performancë.



Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyç të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorët e jashtëm (supozime)
planifikojnë dhe të monitorojnë zbatimin e politikës kombëtare për energjinë në nivel vendor.	- Instrumentet e menaxhimit të energjisë dhe proceset e përshtatshme bashkiake janë në zbatim. - Drejtuesit bashkiakë respektojnë sistemin e menaxhimit të energjisë si bazë për përcaktimin e pikësnyimeve dhe monitorimin e arritjeve.	- Raportet për projektin - Raporti i vlerësimit	- Një kërkesë tjetër për ruajtjen e interesit të tyre është mundësia e marrjes së financimit për masat e planifikuara të EE-së.
Veprimtaritë kryesore në produktin 1a		Shënime	
1a-1: Krijohen dhe vihen në funksion strukturat organizative vendore të menaxhimit të energjisë.			
1a-2: Mbështetet shqyrtimi dhe zbatimi i planeve bashkiake të energjisë dhe dokumentohen përmirësimet në performancën e energjisë.		Zhvillim kapacitetesh për hartimin e PBE-ve në kuadër të produktit 2b.	
1a-3: Bëhen të mundura instrumente shqiptare të menaxhimit të energjisë të bazuara në instrumentet e ÇEE-së, dhe hartohen e zbatohen procese të përshtatshme.			
1a-4: Mundësohet një projektim paraprak i një kuadri kombëtar për menaxhimin e energjisë, i frymëzuar nga ÇEE-ja.		Kjo veprimtari lidhet me komponentin 1B.	
Produkti 1b (nëse 1C zbatohet): Miratohet dhe vihet në funksion një kuadër kombëtar për menaxhimin e energjisë.	- Ngrihet një njësi kombëtare zbatimi për këtë kuadër. - Qeveria e Shqipërisë mbështet këtë kuadër. - Nr. i bashkive shtesë, që i bashkohen kuadrit të menaxhimit të energjisë. - Njësia kombëtare e zbatimit ofron rregullisht kurse trajnimi orientues për bashkitë e reja, që i shtohen kuadrit.		- Agjencia së Eficiencës së Energjisë është e aftë dhe e gatshme të ndërmarrë detyrën e NJMP-së për këtë kuadër.
Veprimtaritë kryesore në produktin 1b		Shënime	
1b-1: Përfundimi i projektimit të një kuadri për menaxhimin e energjisë përfshirë përcaktimin institucional, procesin e certifikimit, modelin e financimit dhe të biznesit dhe strategjinë e zgjerimit.		Kjo veprimtari lidhet me komponentin 1C.	
1b-2: Ngritja e kuadrit në nivel kombëtar: ngritja e një njësie kombëtare që ndërmerr përgjegjësitë e zbatimit të të gjithë kuadrit.			
1b-3: Ngritja e skemave afatgjata të shtysave.			
1b-4: Mbështetje për promovimin e kuadrit dhe përfshirjen e bashkive shtesë.			
Produkti 2a: Bashkitë e ndërgjegjshme për energjinë kanë aftësi të përmirësuara planifikimi dhe zbatimi të projekteve të eficiencës së energjisë dhe të burimeve të energjisë së rinovueshme, të shpalosura si shembuj konkretë në investimet me përfitime të shpejta.	- Në procesin e hartimit të projekteve zbatohen rregullisht udhëzime, që integrojnë praktikën më të mirë. - Cilësia e studimeve dhe e dokumentacionit të projektit sa vjen e rritet krahasuar me fillimin e projektit. - Efektet specifike të investimeve me përfitime të shpejta: a) kwh të kursyer përmes masave EE-së dhe kwh të prodhuar nga BER-të; b) Shkarkimet e gazit serrë të kursyera ose të shmangura në CO₂ eq; c) rehati dhe siguri e shtuar për përdoruesin fundor.	- Udhëzimet e ndërtimit. - Shembuj të dokumentacionit të projekteve dhe të studimeve. - Tregues të shkarkimeve dhe të konsumit të energjisë për investimet me përfitime të shpejta krahasuar me një normë fillestare bazë.	
Veprimtaritë kryesore në produktin 2a:			



Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyç të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorët e jashtëm (supozime)
2a-1: Përkuftizohen në detaje dhe miratohen koncepti i përfitimit të shpejtë dhe i zbatimit.			
2a-2: Mundësohen projektme të detajuara teknike dhe lejet e ndërtimit.			
2a-3: Kryhet prokurimi dhe tenderimi vendor i përbashkët.		Do të kryhet vetëm një tender me lote për secilën bashki.	
2a-3: Investimet me përfitime të shpejta zbatohen bashkërisht, kolaudohen dhe dorëzohen.			
Produkti 2b: Masat për zhvillim kapacitetesh të synuara, zhvillim institucional dhe ndërgjegjësim në nivel vendor dhe kombëtar japin kontribut për zbatimin me sukses të menaxhimit bashkiak të energjisë dhe investimeve me përfitime të shpejta dhe përforcojnë pronësinë dhe mbështetjen politike.	- Agjencia e Eficiencës së Energjisë përfshihet aktivisht në masat e zhvillimit të kapaciteteve. - Stafi i bashkisë është i aftë të organizojë dhe përmbushë përgjegjësitë e veta lidhur me sistemin e menaxhimit të energjisë (shihni produktin 1a) - Drejtuesit e informuar vendorë marrin vendime lidhur me energjinë, bazuar në sistemet e menaxhimit të energjisë dhe instrumentet përkatëse.	- Baza e të dhënave të projektit. - Raportimi për projektin. - Raporti i vlerësimit.	- Agjencia e Eficiencës së Energjisë ka kapacitete të mjaftueshme dhe është e përkushtuar për zhvillimin e kapaciteteve.
Veprimtaritë kryesore në produktin 2b: 2b-1: Rritet ndërgjegjësimi për EE-në dhe menaxhimin bashkiak të energjisë.		Shënime Kjo veprimtari do të ndahet në disa nënveprimtari, në përputhje me masat e Strategjisë së Ndërgjegjësimit dhe Komunikimit, si: faqe interneti, broshura, aktivitete të informacionit publik, ndërgjegjësim në shkollë apo të nxëniet ndërmjet homologëve.	
2b-2: Mundësohet dhe zbatohet një plan për ngritjen e kapaciteteve për të forcuar strukturat e menaxhimit të energjisë në nivel kombëtar dhe vendor.			
2b-3: Mundësohen dhe zhvillohen rregullisht kurse hyrëse trajnimit për menaxhimin bashkiak të energjisë.			
2b-4: Lehtësohet hartimi i planeve bashkiake të energjisë.		Me kalimin e kohës trajnimit për hartimin e PBE-ve duhet të bëhet produkt themelor i Agjencisë së Eficiencës së Energjisë.	
2b-5: Forcohen kapacitetet e stafit të njësisë së menaxhimit të energjisë dhe të ekspertëve të bashkisë për të hartuar propozime projektesh të suksesshme dhe për të menaxhuar zbatimin e tyre.		Me qëllim theksimin e rëndësisë së procesit të planifikimit, projektpropozimet duhet të hartohen për projekte të parashikuara si pjesë e objektivit të PBE-ve.	



SHTOJCA 3

PROGRAMI I PROJEKTIT (PARAPRAK)

Shënim. Programi i Projektit do të përditësohet gjatë fazës së ideimit në vitin 2021.

[illegible]



SHTOJCA 4

BUXHETI PARAPRAK I PROJEKTIT (NË CHF)

Konsulenti i zbatimit	2.750.000
Investimet me përfitime të shpejta	2.100.000
Vlerësimi i jashtëm përpara nisjes së zbatimit të komponentit 1C	50.000
Provizionet e Projektit	400.000
Kontributi i përgjithshëm i SECO-s për SEMP	5.300.000
Kontributi vendor nga bashkitë pilot	630.000
Buxheti i SEMP-së, gjithsej	5.930.000

SHTOJCA 5

PËRDORIMI DHE MENAXHIMI I FONDEVE KONDRAPARTI (CPF)

Pas nënshkrimit të MP-së, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të nxjerrë një urdhër të përditësuar, që përcakton se NJMP-ja e Projektit të Bashkive me Energji Inteligjente (SEMP) ka të drejtën e menaxhimit të dy CPF-ve: CPF-në e PTDP (13.950.000 CHF) dhe CPF-në e DRCRP-së (11.800.000 CHF). Urdhri i përditësuar përfshin të gjitha parimet përkatëse për dorëzimin, përzgjedhjen, zbatimin, raportimin, monitorimin, auditimin dhe vlerësimin e projektit. Ky urdhër i referohet:

- Shtesës së Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Zvicrës për akordimin e asistencës financiare për Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (PTDP), miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 14.12.2016, dhe nënshkruar nga ministri i Financave dhe Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, më 20.1.2017.

- Marrëveshjen e Projektit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Zvicrës për akordimin e asistencës financiare për Projektin e Rehabilitimit të Kaskadës së Lumit Drin (DRCRP) nënshkruar nga ministri i Financave dhe Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, datë 13.10.1994, dhe ndryshimin 2, të nënshkruar nga ministri i Financave dhe Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, datë 20.1.2017.

Urdhri përmban dispozitat e mëposhtme:

1. NJMP-ja e SEMP-së është e mandatuar të menaxhojë dy CPF-të, në kuadër të shtesave të Marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Zvicrës për akordimin e asistencës financiare për PTDP-në dhe DRCRP-në.

2. NJMP-ja e SEMP-së ngre një Komision të CPF-së, që përbëhet nga të paktën pesë anëtarë të kualifikuar.

3. Komisioni i CPF-së mbështetet nga një sekretar që mban procesverbalin e mbledhjeve dhe menaxhon dokumentacionin përkatës.

4. Një përfaqësues nga komisioni i CPF-së emërohet si person kontakti me Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri dhe informon ambasadën sipas rastit.

5. Përdorimi i CPF-ve

5.1 Komisioni i CPF-ve vlerëson dhe miraton projektpropozimet në sektorin e energjisë, veçanërisht në fushat e eficiencës së energjisë dhe energjive të rinovueshme, përfshirë komponentët socialë. Ndër të tjera, projektet e propozuara sigurojnë shërbime publike përfshirëse dhe cilësore, integrojnë grupet e cënueshme, mbështesin barazinë gjinore dhe pakësojnë pabarazitë rajonale. Komisioni i CPF-ve u jep përparësi projektpropozimeve të dorëzuara nga bashkitë pilot të SEMP-së, që janë rekomanduar për financim nga ana e Komitetit Drejtues të SEMP-së.

5.2 Komisioni i CPF-ve miraton vetëm projekte për të cilat nuk vihen në dispozicion financime të tjera alternative nga ana e sektorit privat (plotësueshmëria në rast mungese).

5.3 Ambasada e Zvicrës në Tiranë, moskundërshtimin e saj lidhur me projektet e përzgjedhura nga Komisioni i CPF-ve, bazuar në kriteret në vijim: i. komponenti social i projektit; ii. ndikimi zhvillimor; iii. përputhja me Projektstrategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2027 të Shqipërisë, Strategjinë e Sektorit të Energjisë 2018–2030, Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planin e saj 2019–2030; dhe iv. plotësueshmërinë në rast mungese.



5.4 Të ardhurat nga CPF-të vihen në dispozicion për grante për blerjen e pajisjeve, pjesëve të këmbimit, punimet vendore përfshirë ndërtimin, bazën materiale ose shërbimet.

5.5 CPF-ja financon vetëm kostot që lidhen drejtpërsëdrejti me objektivat e projekteve të miratuara. Asnjë e ardhur nga CPF-të nuk përdoret për pagesën e detyrimeve apo të taksave (detyrime doganore, detyrime importi, taksa, tarifa të çdo lloji), që rrjedhin nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë apo në sajë të organeve në varësi të shtetit.

5.6 Në rast se projekti zbatohet nga komisioni i CPF-ve, një vlerë deri në masën 5% të të ardhurave të CPF-ve mund të vihet në dispozicion për mbulimin e shpenzimeve administrative të hasura nga Komisioni i CPF-ve për zbatimin e projektit, si dhe për veprimtaritë e nevojshme të vlerësimit paraprak, monitorimit, vlerësimit dhe auditit që lidhen me projektet e financuara nga CPF-të.

5.7 Anëtarët e Komisionit të CPF-ve nuk kanë të drejtë të marrin shpërblim nga CPF-të.

6. Rregullat dhe procedurat për dorëzimin e projekteve në Komisionin e CPF-ve dhe lidhur me menaxhimin e CPF-ve parashikojnë dy protokolle për dorëzimin e projekteve:

6.1 Një bashki pilot e SEMP-së propozon një projekt të financueshëm, që është rekomanduar për financim përmes CPF-ve nga ana e Komitetit Drejtues të SEMP-së.

6.2 Thirrje e hapur: i. Kreu i Komisionit të CPF-ve nxjerr një thirrje për propozime në të paktën dy media; ii. thirrjet për propozime përmbajnë informacion mbi objektin e projektpropozimeve, kriteret e vlerësimit, volumnin financiar, aplikantët e pranueshëm, afatin e dorëzimit të projektpropozimeve.

7. Komisioni i CPF-ve mbledhet jo më vonë se 10 ditë nga dorëzimin i projektpropozimeve, me qëllim vlerësimin dhe përzgjedhjen e projektit apo të projekteve që përmbushin të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në pikën 5 të këtij urdhri.

8. Mbledhjet e Komisionit të CPF-ve mbahen me të paktën një kuorum prej 3 anëtarësh të pranishëm. Për çdo mbledhje mbahet dhe administrohet procesverbal. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e komisionit të CPF-ve.

9. Vendimet e komisionit të CPF-ve merren me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje.

10. Njoftimi për raportet dhe mbledhjet bëhet përmes postës elektronike.

11. Komisioni i CPF-ve mund të kërkojë ekspertizë teknike lidhur me çështjet teknike apo financiare të projekteve të propozuara nga strukturat përgjegjëse në MIE, përfshirë institucionet vartëse apo shoqëritë tregtare të kontrolluara nga MIE, si dhe institucione të tjera jashtë MIE-s, dhe nëse është e nevojshme nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

12. Komisioni i CPF-së ka të drejtën të kërkojë dokumentacion, informacion dhe/ose sqarime nga ana e aplikantëve, përfshirë bashkitë pilot, lidhur me projektpropozimet dhe komponentët e tyre.

13. Ambasada e Zvicrës në Tiranë do të akordojë moskundërshtimin e saj lidhur me projektet e përzgjedhura nga komisioni i CPF-ve, bazuar në katër kriteret e përmendura në pikën 5.3, brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit të informacionit. Në rast se Ambasada e Zvicrës në Tiranë nuk kthen përgjigje brenda 10 ditëve, Komisioni i CPF-ve e zgjat këtë afat me 10 ditë të tjera.

14. Komisioni i CPF-ve vendos për përzgjedhjen apo refuzimin e projekteve të dorëzuara nga aplikantët vetëm pas marrjes së moskundërshtimit nga ana e Ambasadës së Zvicrës në Tiranë dhe pas përfundimit të procesit të shqyrtimit.

15. Vendimi i Komisionit të CPF-ve për projektin e përzgjedhur, së bashku me një paraqitje të projektit i dorëzohen kreut të NJMP-së. Pas marrjes së konfirmimit nga ana e kreut të NJMP-së për projektin e përzgjedhur, personi i kontaktit në Komisionin e CPF-ve informon Ambasadën e Zvicrës në Tiranë, lidhur me konfirmimin e kreut të NJMP-së, procesin dhe projektin e përzgjedhur, përfshirë të gjitha informacionet shtesë që mund të kërkojnë nga ana e Ambasadës.

16. Pasi Ambasada e Zvicrës në Tiranë të ketë akorduar moskundërshtimin e saj për projektin e përzgjedhur nga komisioni i CPF-ve, kreu i NJMP-së konfirmon projektin e përzgjedhur dhe konfirmon financimin e projektit, si dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar financimin në kohën e duhur, dhe njofton zyrtarisht aplikantët lidhur me vendimin.



17. Baza ligjore për procedurat e prokurimit me fonde CPF është legjislacioni për prokurimin publik i Shqipërisë.

18. MIE vë në dispozicion buxhetin e nevojshëm për rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për kontraktorët, që kanë zbatuar projekte që po financohen përmes këtyre CPF-ve.

19. Komisioni i CPF-ve ndërmerr rregullisht një monitorim të programit në tërësi, lidhur me zbatimin e projekteve të financuara përmes CPF-ve.

20. Komisioni i CPF-ve i paraqet Ambasadës së Zvicrës në Tiranë raporte vjetore për CPF-të, të cilat përmbajnë informacion për ecurinë e projekteve të financuar përmes CPF-ve, në zbatim e sipër, projekteve të planifikuara, buxhetet e projekteve, detajet e transaksioneve të CPF-ve dhe bilancin e CPF-ve. Raportet vjetore të CPF-ve përfshijnë raportet vjetore të auditit financiar.

21. Procedurat për raportimin dhe për monitorimin e zbatimit të projekteve janë të përshkruara në kontratat e lidhura me kontraktorët përkatës, që përzgjidhen si fitues dhe bazohen në procedurat e prokurimit publik në Shqipëri.

22. Kërkesat e auditit për projektet, që janë në zbatim e sipër ose në fazën përfundimtare, janë ato që përcaktohen në legjislacionin shqiptar dhe në nenin 6 të shtesës së marrëveshjes për PTDP-në, i cili përcakton sa vijon:

22.1 Çdo vit, një auditues i pavarur me seli në Shqipëri, i emëruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shqyrton veprimtaritë e CPF-së dhe auditon pasqyrat e tij financiare, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Rezultatet e auditit përmbledhen në raportin vjetor të auditit financiar, që i bashkëngjitet raportit vjetor të CPF-së.

22.2 Kostot e auditeve të rregullta vjetore financiare mbulohen nga CPF-ja. Në rast se raporti i auditit vëren parregullsi, që nuk janë të pranueshme për Komisionin e CPF-ve, akordimi i fondeve për projekte të mëtejshme mund të pezullohet nga ana e CPF-së deri sa parregullsitë të korrigjohen ose të anulohen, nëse ato nuk mund të korrigjohen. Në të dyja rastet, Ambasada e Zvicrës në Tiranë njoftohet menjëherë.

22.3 MFE-ja monitoron shlyerjen në kohë të detyrimeve të KESH-it në drejtim të CPF-ve.

VENDIM

Nr.46, datë 26.1.2022,

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE TË KANDIDATURAVE PËR KRYETAR DHE ANËTARË TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 25, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të detajuara për procedurën përzgjedhëse të kandidaturave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik për garantimin e profesionalizmit e të transparencës gjatë përzgjedhjes, mbështetur në kriteret profesionale, për të përmbushur detyrat e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik.

2. Përzgjedhja e kandidaturave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura të konkurrimit, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

3. Procedura përzgjedhëse për kandidaturat për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik zhvillohet nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe në përputhje me pikën 3, të nenit 25, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”.

4. Me marrjen e njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vendeve vakante, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ngrë një komision *ad hoc*, të përbërë nga 3 (tre) anëtarë, nga të cilët një përfaqësues i Kryeministrit, një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike dhe një përfaqësues i Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

5. Anëtari i komisionit *ad hoc* zgjidhet midis personave, që plotësojnë këto kriteret:

a) Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” ose të barasvlefshme me të;

b) Për anëtarin përfaqësues të Kryeministrit dhe të Departamentit të Administratës Publike, të



ketë punuar për jo më pak se 5 (pesë) vjet në nivel jo më të ulët se niveli i mesëm drejtues dhe/ose të ketë njohuri në fushën e prokurimeve;

c) Për anëtarin përfaqësues të Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune;

ç) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) Të mos ketë qenë anëtar i partive politike për 3 (tri) vitet pararendëse nga data e emërimit;

dh) Të mos ketë qenë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) Të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Kryeministrit dhe në Buletin e Njoftimeve Publike për të paktën 2 (dy) javë. Njoftimi përmban:

a) kriteret e përgjithshme, që duhet të përmbushin kandidaturat, sipas parashikimeve të nenit 26, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”;

b) listën e dokumenteve që duhen paraqitur;

c) afatin e fundit dhe adresën, ku duhet të paraqiten aplikimet;

ç) mënyrën e njoftimit/komunikimit me aplikantët.

7. Komisioni *ad hoc* i përzgjedhjes bën vlerësimin e kandidaturave të paraqitura brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve, bazuar në jetëshkrimin e kandidatëve dhe në intervistën e tyre me gojë. Nëse numri i kandidaturave të paraqitura është i lartë, atëherë vlerësimi i tyre nga komisioni mund të zgjatet, por jo më shumë se 20 (njëzet) ditë kalendarike.

8. Fillimisht, komisioni *ad hoc* i përzgjedhjes bën vlerësimin e dokumenteve të paraqitura nga aplikantët, për të parë nëse ato plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”. Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni *ad hoc* përgatit listën me emrat e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për t’u emëruar dhe ia përcjell zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për t’i njoftuar ata brenda 2 (dy) ditëve.

9. Komisioni *ad hoc* i përzgjedhjes vazhdon me vlerësimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”. Vlerësimi maksimal është 100 pikë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas një procedure që përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

a) Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, të përvojës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, deri në 70 pikë, sipas pikës 11, të këtij vendimi;

b) Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë.

10. Çdo anëtar i komisionit *ad hoc* të përzgjedhjes jep vlerësimin e tij individual për secilin kandidat. Vlerësimi përfundimtar për kandidatin llogaritet si mesatare e pikëve të vendosura nga secili prej anëtarëve.

11. Metoda e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve të jetë, si më poshtë vijon:

11.1. Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili do të kryhet në bazë të:

a) diplomës së ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” ose të barasvlefshme me të në:

i. drejtësi:

10 pikë

ii. inxhinieri, ekonomik:

8 pikë;

iii. gradë shkencore, titull akademik:

nga 2 deri në 5 pikë shtesë;

iv. certifikata apo kualifikime të tjera:

3 deri në 10 pikë.

b) përvojës në punë, që duhet të jetë 8 (tetë) vjet:

10 pikë, si dhe:

i. përvojës mbi 8 (tetë) vjet:

nga 2-5 pikë shtesë;

ii. përvojës në pozicione drejtuese:

nga 2-5 pikë shtesë;

iii. përvojës si gjyqtar, ndërmjetësues apo arbitër:

2-5 pikë shtesë.

c) Përvojës në prokurime, që duhet të jetë 3 (tre) vjet:

10 pikë, si dhe:

i. mbi 3 vjet:

2 pikë shtesë;

ii. 5-10 vjet:

5 pikë shtesë;

iii. mbi 10 vjet:

10 pikë shtesë.



11.2. Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve për kryetar të Komisionit të Prokurimit Publik, që do të kryhet në bazë të:

- | | |
|---|------------------------------|
| a) diplomës së ciklit të dytë të studime
“Master i shkencave” ose të barasvlefshme me të, në drejtësi: | 10 pikë, si dhe: |
| i. gradë shkencore, titull akademik: | deri në 3 pikë shtesë; |
| ii. për certifikatën apo kualifikimet e tjera: | deri në 3 pikë shtesë. |
| b) Përvojës në punë, që duhet të jetë 8 (tetë) vjet: | 10 pikë, si dhe: |
| i. mbi 8 (tetë) vjet përvojë pune: | 2 pikë shtesë; |
| ii. përvojës si gjyqtar, ndërmjetësues apo arbitër: | 2-5 pikë shtesë. |
| c) Përvojës në pozicione drejtuese, 2 (dy) vjet: | 10 pikë, si dhe: |
| i. përvojës në nivelin e lartë drejtues (TND): | 2 pikë shtesë; |
| ii. përvojës mbi 2 vjet: | nga 2 deri në 5 pikë shtesë. |
| ç) Përvojës në prokurime, 3 (tre) vjet: | 10 pikë, si dhe: |
| i. mbi 3 vjet: | 2 pikë shtesë; |
| ii. 5-10 vjet: | 5 pikë shtesë; |
| iii. mbi 10 vjet: | 10 pikë shtesë. |

12. Në përfundim të vlerësimit, komisioni *ad hoc* i përzgjedhjes rendit kandidatët në bazë të pikëve të marra dhe ia dërgon listën Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për vendimmarrje të mëtejshme nga Këshilli i Ministrave. Me qëllim vijimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, Këshilli i Ministrave dërgon në Kuvend listën e kandidatëve të kualifikuar sipas renditjes dhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për t'u emëruar.

13. Vendimi nr.521, datë 20.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë